

## ENTELA KORE (MAZE)

### VEÇORI TË FJALËFORMIMIT NË TË FOLMEN ÇAME

Në vijueshmërinë e studimeve tona për të folmen çame, po ndalemi në një fushë tepër të rëndësishme për gjuhësinë siç është ajo e fjalëformimit. Studimet për këtë fushë kanë filluar qysh herët me gramatikat<sup>1</sup> e Hahnit, Gj. Pekmezit, Kamardës, Dozonit, S. Frashërit etj. Në këto punime të rëndësishme jepen sprovat e para për identifikimin e mjeteve gjuhësore që marrin pjesë në formimin e fjalëve të reja.

Disa vite më vonë (në mesin të shek. XX) një vepër tjetër e rëndësishme do t'i vinte në ndihmë mbarë studimeve gjuhësore. A. Xhuvani dhe E. Çabej me studimin e tyre mbi parashtesat dhe prapashtesat e gjuhës shqipe<sup>2</sup>, sollën një inventar të plotë mbi mënyrat dhe mjetet e fjalëformimit të gjuhës shqipe. Në hullinë e këtyre studimeve nuk mund të lëmë jashtë vëmendjes sonë dhe një monografi të posaçme mbi *Formimin e emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe* nga prof. Enver Hysa. Duke pasur parasysh këto punime me vlerë për mbarë gjuhësinë shqiptare, kemi mbështetur në to dhe studimin tonë për këtë të folme.

E folmja çame si nëndialekt i gjuhës shqipe, paraqet të njëjtat veçori për formimin e fjalëve të reja, por me disa dallime që e diferencojnë këtë të folme nga trugu i përbashkët. Mbështetja jonë në këto punime do të ishte frytdhënëse për një paraqitje të saktë të elementëve fjalëformues për këtë të folme. Gjithashtu, një studim më të detajuar rreth fjalëformimit për të folmen çame, mund të shohim dhe në veprën e Q. Haxhihasanit për të folmen e banorëve të Çamërisë<sup>3</sup>, i cili me mjeshtëri ka spikatur vlerën dhe pasurinë e kësaj së folmeje.

Për sa i përket fjalëformimit çamërishtja ka ndjekur të njëjtat etapa ashtu si dhe të folmet e tjera<sup>4</sup>. Për të bërë një studim sa më të plotë mbi

---

<sup>1</sup> Shih. E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2004, f. 23-25.

<sup>2</sup> A. Xhuvani- E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, Vep. I, Tiranë, 1980.

<sup>3</sup> Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, vëll. II, Tiranë, 1974.

<sup>4</sup> Shih Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, "Dialektologjia shqiptare", II, Tiranë, 1974, f. 3-10.

fjalëformimin për këtë të folme, jemi bazuar tek të gjitha hulumtimet e bëra deri më sot për çamërishten. Numrin më të madh të fjalëve të formuara me ndajshesa në këtë të folme, ashtu si në mbarë gjuhën shqipe, e zë formimi me prapashtesa.

Përgjithësisht e folmja çame karakterizohet nga disa trajta dhe forma të veçanta fjalësh, janë pikërisht këto formime fjalësh që na tërheqin vëmendjen për të identifikuar përbërjen e tyre. Në leksikun e çamërishtes gjejmë fjalë të parme dhe jo të parme, fjalë të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura. Konkretisht, në këtë punim do të ndalemi në disa elementë të veçantë që marrin pjesë në fjalëformim, duke pasqyruar kështu trajtat më të veçanta kësaj së folmeje.

Duke vështruar e studiuar mbarë gjuhën shqipe, vëmë re se edhe në të folmen çame formantet parashtesore janë më të pakta në numër krahasuar me formantet prapashtesore. Këto parashtesa pavarësisht numrit të vogël, tërheqin vëmendjen njësoj si prapashtesat. Një tjetër mënyrë e formimit të fjalëve të reja që mund të përmendim këtu është dhe formimi me kompozim, për të cilin do të japim disa shembuj. Ndërsa formimet me përngjitje në këtë të folme, dalin me disa forma të veçanta të cilat dallojnë nga të folmet e tjera.

Në këtë të folme njësitë e reja leksikore të formuara me parashtesa, tregojnë për disa veçori të përbashkëta mes çamërishtes dhe autorëve tanë të vjetër (për një fenomen të tillë çamërishtja më shumë se kushdo e folme tjetër ka ruajtur trajtat më arkaike të fjalëve). Kështu që, disa formime që kemi evidentuar për këtë të folme me parashtesa, janë përdorur më parë edhe në veprën e Buzukut “Meshari”<sup>5</sup>.

Ndër të tjera, në fushën e fjalëformimit krahas formimeve me parashtesa dhe prapashtesa me burim vendas, çamërishtja dallohet për praninë e elementeve të huaja<sup>6</sup> që marrin pjesë në fjalëformim. Por, nëse bëjmë një renditje të këtyre formanteve, numri i tyre del më i vogël po ta krahasojmë me fjalët e tjera.

Lidhur me veçoritë që paraqesin këto parashtesa dhe prapashtesa, ne do të japim vetëm një pasqyrë të shkurtër të këtyre formimeve. Në fillim po ndalemi tek formimi i fjalëve me parashtesa.

<sup>5</sup> Shih: E. Hysa, L. Xoxe, *Vëzhgime për formimin e fjalëve të “Meshari” i Gjon Buzukut*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Filologjisë, 22/1, Prishtinë 2004, f. 237-240.

<sup>6</sup> Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, “Dialektologjia shqiptare”, II, Tiranë, 1974, f. 3.

### **Formime fjalësh me parashtesa**

Nga hulumtimet e bëra për mënyrën e fjalëformimit të fjalëve në leksikun çam, jemi përqendruar në disa të dhëna konkrete mbi formimin e disa fjalëve me parashtesa për këtë të folme. Parashtesimi, si mënyrë e veçantë e fjalëformimit, ka vepruar sidomos në fushën e ndajfoljeve, por ka disa parashtesa që dalin edhe në fushën e foljeve. Fjalët e formuara me parashtesa janë më të pakta në numër, madje, në disa prej tyre, mund të themi se ato kanë ndodhur si rezultat ndikimit të gjuhëve të huaja.

#### **Parashtesa a-**

Sipas përkufizimit të A. Xhuvanit – E. Çabej, kjo parashtesë u ngjitet përemrave dëftorë, përemrave të pacaktuar, ndonjë mbiemri dhe ndonjë ndajfoljeje përemërore, për të dhënë një kuptim deiktik të largësisë.<sup>7</sup> Këtë parashtesë e kemi hasur tek ndajfolje të tipit: *aradha* dhe *arrotulla* (*ulen në glunj arrotulla sufrait*). Shembuj të tillë dalin me të njëjtin funksion dhe në veprën e Q. Haxhihasanit.

Tek arbëreshët e Italisë, e njëjta parashtesë del po me këtë kuptim, duke formuar disa ndajfolje vendi dhe emra vendi ose personash: *alargu*, *aposhta*, *Anapuli* (Nauplion e Moresë)<sup>8</sup>, çka tregon një tipar të përbashkët për mbarë gjuhën shqipe.

#### **Parashtesa kas-**

Përveç rasteve të tilla që përmendëm më sipër, një parashtesë që e ruan më së miri origjinalitetin e kësaj së folmeje është dhe parashtesa **kas-**. Në të folmen çame, kjo parashtesë përdoret për formimin e ndajfoljeve të kohës, duke shprehur një kuptim më të qartë të referimit të kohës. Lidhur me këtë parashtesë po japim disa shembuj: *kasdej*, *kasnjënatëzë*, *kasmot*, *kasviti* (me kuptimin e paskohësisë).

#### **Parashtesat para-, pismo-**

Këto parashtesa përdoren për të ndërtuar ndajfolje kohore të tipit: *paradej*, *pismodej*, *paranjëdizë*, *pismonjëdizë*<sup>9</sup>. Këto parashtesa dalin të afërta nga kuptimi me rastet e mësipërme të formuara me parashtesën *kas-*.

---

<sup>7</sup> A. Xhuvani – E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, Vep. I, Tiranë, 1980, f. 365.

<sup>8</sup> A. Xhuvani – E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, Vep. I, Tiranë, 1980, f. 365.

<sup>9</sup> Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, “Dialektologjia shqiptare”, II, Tiranë, 1974, f. 3.

### **Parashtesa s-**

Ndër parashtesat më pak të përdorura në këtë të folme kemi hasur dhe parashtesën **s-** e cila u jep fjalëve të njëjtin kuptim (antonimik) si parashtesat **sh-** dhe **ç-**: *palos-shpalos-çpalos*, *skoqis-çkoqis-shkoqis*.<sup>10</sup> Lidhur me këto parashtesa që u japin fjalëve një kuptim të kundërt nga ai ekzistues, mund të themi se në gjuhën shqipe dalin si pasqyrime të variantit dialektor.<sup>11</sup>

### **Parashtesa kollo-**

Kjo parashtesë me ndikim nga greqishtja, në këtë të folme gjen zbatim në disa emra dhe ndajfolje. Me këtë parashtesë, janë formuar disa fjalë që zakonisht u japin emrave ose pjesëve të ndryshme të ligjëratës një kuptim përkeqësues. Fjalët që kemi gjetur me këtë parashtesë po i rendisim më poshtë: *kollopan-e*, *kollofaqe*, *kollotumb*, *kollogjer* (në disa raste dhe *kollojer*) etj.

### **Parashtesa kor(r)o-**

Duke iu referuar studimeve gjuhësore për këtë ndajshitesë, mund të themi se emërtimet lidhur me këtë parashtesë vijnë më së shumti si ndikime analogjike nga fjalë të tjera. Këtë parashtesë e kemi hasur shumë rrallë në formime emrash e mbiemrash: *korroviq* (lloj ëmbëlsire me qumësht), dhe *korrobace*. Në varësi të moshës kemi gjetur ndërtime të këtyre fjalëve me **kurru-**, si *kurruviq* dhe *kurrubac*.

Gjithashtu, nuk mund të lëmë pa përmendur faktin që kjo parashtesë para së gjithash është një element i toskërishtes që me shumë gjasa është shtrirë dhe në çamërishte.

### **Parashtesa kse-**

Në lidhje me veçoritë që paraqesin këto formime parashtesore, po ndalemi në një tjetër parashtesë me origjinë nga greqishtja. Kjo parashtesë karakteristike për banorët e Çamërisë përdoret para foljeve duke u dhënë atyre një kuptim të kundërt nga ai përkatës: *ksebej*, *ksebëra*, *ksemollojis*

<sup>10</sup> Shih: Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, "Dialektologjia shqiptare", II, Tiranë, 1974, f. 8.

<sup>11</sup> Për këtë parashtesë dhe variantet e tjera me **c** e **ç**, mund të shohim një studim më të plotë në veprën:

A. Xhuvani – E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, Vep. I, Tiranë, 1980, f. 367-369.

etj. Formime të tilla parafoljore janë përdorur edhe në të folme të tjera, si Gjirokastër dhe në të folmet arbëreshe.

### Formime fjalësh me prapashtesa

Ashtu si mbarë fjalëformimi në gjuhën shqipe edhe në çamërishte prapashtesat dalin jo vetëm të larmishme, por kanë formuar dhe numrin më të madh të fjalëve. Prapashtesimi këtu ka vepruar sidomos në fushën e emrave dhe të foljeve, por mjaft prodhimtare prapashtesat dalin dhe në fushën e mbiemrave dhe ndajfoljeve.

Ndër prapashtesat më të spikatura dhe që kanë formuar numrin më të madh të fjalëve, ne po përmendim disa prej tyre: prapashtesa **-at, -ot, -jot, -it, -qot -anj, -aj, -atë, -eshë, -ël, -im, -omë, -esë, -ëz-ë, -ush; -as, -eps, -is, -os; -azi, -isht, -o; -shim, -çim (shëm), -nik, -të, -tor, -imtë** etj.

Pra, siç e shohim dhe nga renditja e këtyre prapashtesave, mund të themi se edhe e folmja çame paraqet larmishmëri në fjalët e formuara me prapashtesa. Le të ndalemi më konkretisht në disa pjesë të ligjëratës për të parë mënyrën e fjalëformimit.

### Emri

Formimi i emrave nga emra të tjerë është një ndër karakteristikat themelore për këtë të folme. Me anë të prapashtesimit në çamërishte janë krijuar trajta të veçanta fjalësh, të cilat kanë dhënë emërtime të reja fisesh, njerëzish, banorësh dhe më gjerë.

Prapashtesa **-at(ë)** në këtë të folme u bashkëngjitet temave emërore për të formuar emra fisesh, llagapesh, vendbanimesh si: *Dellatë, Omeratë, Resulatë* etj. Kjo prapashtesë është e pranishme edhe në Gjirokastër për formimin e emrave të fiseve dhe vendeve: *Topullatë, Karagjozatë, Manalat, Dunavat*.

Me prapashtesat **-ot, -jot, -qot** janë formuar emra banorësh nga emri i vendit apo krahinës ku jetojnë: *paramithjót, livadhyót, margëlliçót, arpícót, picarjót, shulashót, filaqót* etj.<sup>12</sup>

Me **-anj** formohen disa emra patronimikë: *Kurtanj, Mananj, Velanj*; po kështu me prapashtesën **-aj** kemi disa emërtime të tjera fisesh: *Mazaj, Hysenaj, Idrizaj, Tahiraj, Avdulaj, Tanaj, Resulaj, Rakipaj*.

Ndër prapashtesat më të përdorura në fushën e fjalëformimit në këtë të folme do të veçonim prapashtesën **-eshë**. Me këtë prapashtesë janë formuar

---

<sup>12</sup> Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, "Dialektologjia shqiptare", II, Tiranë, 1974, f. 4.

disa emra të gjinisë femërore, të cilat duke iu bashkëngjitur emrave më zanore kanë formuar emra grash në çamërishte: *Agesha, Hankesha, Alesha, Hamdesha, Ylmesha* etj. Lidhur me këtë prapashtesë do të shtonim se përdorimi i saj në mbarë gjuhën shqipe është mjaft i gjerë, por ndryshon nga çamërishtja pasi në këtë të fundit përftohen vetëm emra grash (nga emrat e burrave). Po përmendim disa shembuj: *mikeshë, sokolëshë, trimëreshë, mbretëreshë, bilbileshtë, luaneshë*.

Me të njëjtin funksion përdoret dhe prapashtesa **-ël(ë)**, e cila edhe kjo si prapashtesa më sipër u shtohet emrave që mbarojnë më bashkëtingëllore. Por, nëse do të bënim një renditje të emrave të formuar me këto prapashtesa, do të vinim re që numrin më të madh e zënë fjalët më prapashtesën **-ël(ë)**: *Hamitëla* (e shoqja e Hamitit), *Veizëla, Mezanëla, Shabanëla, Idrizëla, Osmanëla, Abazëla, Jakupëla, Muharremëla, Barjamëla, Ysmetëla, Sadikëla, Halimëla, Qamilëla, Bashkimëla, Vezirëla*. Për t'i ardhur në ndihmë kësaj rruge të fjalëformimit që në çamërishte është nga më të veçantat, mund të përmendim ekzistencën e këtij fenomeni edhe tek të folmet arbëreshe.

Mjaft produktive paraqitet kjo prapashtesë edhe në disa formime fjalësh nga pjesorja e foljeve: *plasëla, goditëla, ngordhëla*; disa emërtime bimësh, vendesh me këtë prapashtesë: *rigonëla, jashtla, gropëla*.

Prapashtesat të cilat për nga mënyra e fjalëformimit nuk përbëjnë ndryshime thelbësore, pra, janë emërtime të përgjithshme në gjuhën shqipe, po i rendisim më poshtë:

**-im:** *harrim*; **-imë/-im:** *kumbimë/kumbim* (kumbisem); **-omë:** *valomë*; **-esë:** *shërbesë*; **-(ë)z(ë):** *nanëzë*; **-ush:** *lulush*.

### Mbiemri

Ndër prapashtesat më interesante në fushën e mbiemrave do të vinim në dukje prapashtesën **-imtë**, nga e cila janë formuar emra që tregojnë cilësi. Kjo prapashtesë e veçantë për nga kuptimi dhe përdorimi, përmendet edhe në librin e Pedersenit *Albanesische texte, mit glossar*<sup>13</sup> çka tregon për një tipar autentik të çamërishtes: am një të *florimtë*, jataganin e *florimtë*.

Përveç shembullit që trajtuam më sipër, interesante për nga forma paraqiten dhe mbiemrat e formuar me prapashtesën **-shim** dhe variantin e

<sup>13</sup> H. Pedersen, *Albanesische texte, Mit glossar*, Leipzig, 1895, f. 25.

tjetër **-çim**. Tipi i këtyre mbiemrave është i rrallë për nga ndërtimi<sup>14</sup>, por në këtë të folme kemi gjetur disa raste me këtë prapashtesë: *i kollajçim*, *i frikësuaçim*, *i ngeshim*, *i dijshim*.

Nga prapashtesat që formojnë mbiemra të tjerë po përmendim dhe **-nik** në fjalët: *petanik*, *shtatanik*; **-të**: *i paqtë*, *i mprehtë*; **-tor**: *leshtor*.

### Ndajfolja

Në grupin e ndajfoljeve po përmendim disa fjalë ku dy të fundit janë krijuar nën ndikimin e greqishtes: **-azi**: *glunjazi*, **-isht**: *hajdhisht* **-o**: *çamikó*.

### Kompozitat

Përveç emrit, mbiemrit, foljes dhe ndajfoljes, çamërishtja paraqitet mjaft e pasur edhe në fushën e kompozitave, ku më së shumti spikat lirika popullore. Mënyra e ndërtimit të këto kompozita është e veçantë, ku vendin kryesor e zënë kompozitat **emër+emër**: *mjekërrshtupë*, *vetullajatagan*, *qafëmilonjë*, *faqehënë*; **emër+mbiemër**: *bushtërkuqe*, *purtekëglatë*, *tumankuqe*; **emër+pjesore**: *kurrizdalë*, *cipëplasar*, *mesëkëputur* etj.

Si përfundim, mund të themi se pavarësisht numrit të madh ose jo me të cilat dalin këtu format e ndryshme të fjalëve, ajo që është e rëndësishme për ne është struktura dhe mjeti i fjalëformimit. Prandaj në pjesën thelbësore të këtij punimi e kemi vënë theksin vetëm tek ato mjete fjalëformuese që janë karakteristike për këtë të folme. Me këtë rast mund të themi se të gjitha parashtesat dhe prapashtesat që kemi analizuar, përbëjnë një pasuri të mjeteve dhe të mënyrave të fjalëformimit për mbarë gjuhën shqipe.

### BIBLIOGRAFI

Xhuvani, A. - Çabej, E., *Parashtesat e gjuhës shqipe*, Vep. I, Tiranë, 1980.  
Xhuvani, A. - Çabej, E., *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Vep. I, Tiranë, 1980.

---

<sup>14</sup> Sh. Hoxha, *Fjalët e formuara shqipe në veprat e W.M.Leak-ut*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Filologjisë, 22/1, Prishtinë 2004, f. 372-375.

- Hysa, E., *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2004.
- Gramatikë e gjuhës shqipe*, 1, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002.
- Pedersen, H., *Albanesische Texte, mit glossar*, Leipzig, 1895.
- Totoni, M., *Vëzhgime rreth të folmes së qytetit të Gjirokastrës*, SF, 1966/1, Tiranë.
- Haxhihasani, Q., *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, botim i serisë “Dialektologjia shqiptare”, vëll. I, Tiranë 1971; vëll. II, Tiranë, 1974.
- Haxhihasani, Q., *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, “Dialektologjia shqiptare”, II, Tiranë, 1974.
- Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Universiteti i Prishtinës- Fakulteti i Filologjisë, 22/1, Prishtinë, 2004.